



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-25-4802-5-2-5/C1046
14 Nr. 538/25
Dt. 24.06.2025

ANEKS KONTRATË PUNE/SHËRBIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **ILEAA-GR** “sh.p.k. me seli në **Prishtinë**, me ARBK: 810199035 & “ **LimitProject** “sh.p.k. me seli në **Prishtinë**, me ARBK: 811312561 & “ **Rines** “sh.p.k. me seli në **Drenas**, me ARBK: 811167867 & “ **Delta-CCD** “sh.p.k. me seli në **Prishtinë**, me ARBK :810124157, të cilët i përfaqëson **z. Besart Hetemaj**, në tekstin e mëtejme: **KRYESI I PUNIMEVE**,

janë pajtuar të lidhin këtë Aneks Kontrate publike për ekzekutimin e punëve dhe / ose shërbimeve, si në vijim: :
Rikonstruimi i Bulevardit “Adem Jashari”, me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	2	5	48	0	2	5	2	5
Prokurimi Nr.	VU644	2	5	1	2	3	5	2	5/5

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është ekzekutimi i punimeve nga ana e Kontraktuesit, që ka të bëjë me **Punë shtesë të domosdoshme për tu përfunduar tërësisht punimet dhe projekti në fjalë të jetë funksional**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. prokurimi : VU644-25-4802—525 / Nr. të brendshëm të prokurimit : VU644-25-123-525/5

- 1.1 Kontrata fillon së zbatuari nga data e nënshkrimit ndërsa punimet duhen përfunduar me të përfunduar të Kontratës bazë, respektivisht më dt. 10.12.2025 dhe e njëjta nuk mundë të zgjatet apo të vazhdohet.
- 1.2 Sasitë e punimeve dhe ose shërbimeve të saktësuara si në pjesën II. Lista e Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Punimeve) dhe të kësaj Kontrate janë përcaktuar-saktësuara paraprakisht.
- 1.3 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje në mënyrë që të bëjë blerjen e punimev dhe / ose shërbimeve të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2

Kushtet e dërgesës

- 2.1 Ekzekutimi i punimeve do të filloi menjëherë pas dërgimit të ftesës nga Menaxheri i Kontratës ndërsa, punimet shtesë duhen të përfundohen sa më parë me prioritet të lartë dhe brenda një afati të arsyeshëm dhe të pranueshëm kohorë, jo më gjatë se afati i përcaktuar në nenin 1 pika 1.1. të kësaj Aneks Kontrate.

2.2 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i përgjithshëm i punëve shtesë që Autoriteti Kontraktues do ti paguaj Kryesit të Punëve është në shumë prej: 264,047.06€

3.2 Çmimet njësi të punimeve dhe / ose shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Kontraktuesi, e cila është pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj Aneks Kontrate.

3.3 Çmimet e saktësuara si në Përshkrimin e Artikujve pjesë e Dosjes së Tenderit dhe të kësaj Kontrate duhet të jenë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës dhe Porosive të bëra. Ato janë të prera dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve.

3.4 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuar të cilat duhet të pasqyrojnë saktë sasinë - e punimeve dhe / ose shërbimeve të porositura nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

3.5 Shumat do të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kushteve të kësaj Kontrate dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të saktësuara në Dosjen e Tenderit.

3.6 Kontraktuesi ka për obligim që me rastin e fillimit të ekzekutimit të punimeve dhe / ose shërbimeve të respektoj detyrimet e tija në mënyrë që punimet dhe / ose shërbimet të jenë cilësore, në përshtatshmëri të plotë me kushte e kontratës, të përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës. Kontraktuesi merr për obligim që ekzekutimi i punimeve dhe / ose shërbimeve të porositura të bëhet në mënyrë profesionale duke garantuar përdorim adekuat dhe cilësor të materialeve të porositura (materialet dhe elementet përcjellëse të saktësuara në Paramasë/Parallogari) në mënyrë që të garantojnë cilësi të punimeve dhe / ose shërbimeve për një periudhë kohore të saktësuar si në Kushtet e Veçanta të Kontratës respektivisht jo më të shkurtë se 5 vite nga data e pranimit të punimeve dhe / ose shërbimeve, ashtu sikurse është saktësuar në nenin 1 paragrafi 1.9 të Kontratës Bazë nr. 1192/23 dt. 24.10.2023

Neni 4 Ligji i aplikueshëm

4.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 5 Kualiteti

5.1 Kualiteti respektivisht cilësia e punimeve dhe / ose shërbimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 6 Garancioni

6.1 Garancioni i cilësisë dhe përshtatshmërisë së ekzekutimit të punimeve dhe / ose shërbimeve është përgjegjësi ekskluzive e Kryesit të Shërbimeve.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,10% në ditë të vlerës së shërbimeve dhe / ose furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes të çfarëdo artikulli që përgatitet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Nën-kontraktimi

9.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Kryesi i Punimeve dhe / ose Shërbimeve i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Kryesi i Punimeve dhe / ose Shërbimeve nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Kryesin e Punimeve dhe / ose Shërbimeve për vendimin e tij brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërrprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

10.1 Autoriteti kontraktues mundet që të ndërprerë Kontratën menjëherë pasi të konstatoj se Kryesi i Punimeve dhe / ose Shërbimeve nuk po arrin ta përmbushë Kontratën në pajtim me përshkrimin Teknik të saktësuar në Specifikimin Teknik të Dosjes së Tenderit.

Neni 11 Ndërrprerja e Kontratës nga Kryesi i Shërbimeve

11.1 Kryesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërprerë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Kryesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Kryesi i Shërbimeve nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 100 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Kryesit të Shërbimeve.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

12.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

12.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 13 Komunikimi

13.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kryesit të Shërbimeve duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

13.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës së vendit
- (h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

13.3 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 14

Komunikimet

14.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kryesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.




14.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

14.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


14.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kryesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna Vushtrri

Për Kryesin e Punëve : "Ileaa - GR
"sh.p.k. & " LimitProject "sh.p.k. & "
Rinesa "sh.p.k. & " Delta-CCD "sh.p.k.
– Prishtinë

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Besart Hetemaj
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Përfaqësues i Kryesit të Punëve
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.06.2025	Data:	24.06.2024
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E VUSHTRRIË

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i terë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion.						
Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)
PUNET SHITESË						
PUNET E PLLAKAVE DHE BETONIT						
Plakat BETON PLUS Plaka të jashtme të prodhuara sipas udhëzimeve për pjesët e betonit me shenjë cilësie (RiBoN) me sipërfaqe qeramike granti 2 cm të trasha sipas EN 14 411 -G me thithje uji ≤ 0,5% dhe bërthamë betoni 3 cm të trashë me ndarës të derdhur. Sipërfaqe qeramike granti e strukturuar hollë me një pamje natyrale të dyshemesë prej druri. Plakat duhet të jenë produkte nga prodhimi neutral ndaj klimës (certifikimi CCF) me një raport të verifikuar të qëndrueshmërisë. Duhet të respektohen udhëzimet për montim e prodhuesit dhe informacioni në DIN 18318, Format (A/B/H): 60/40-6cm. Gjerësia e fugave: min.3 mm. Ngjyrat: gri e errët me lara, Duhet të plotësoj RiBoN, Qeramikë granti 2 cm + bërthamë betoni 3 cm. Rezistent ndaj mykut, myshkut, likenit etj. Thithja e ujit ≤ 0,5%, për të bërë të lehtë pastrimin Rezistent ndaj ngrirjes/shkrirjes, Rezistenca ndaj rrëshqitjes: R11, Mostra duhet t'i paraqiten klientit.	m ²	2,044.00	10.68	18.00	12.60	21,825.76
						3,928.64
						25,754.40

Pllakat BETON PLUS Pllaka të jashtme të prodhuara sipas udhëzimeve për pjesët e betonit me shenjë cilësie (RiBoN) me sipërfaqe keramike graniti 2 cm të trasha sipas EN 14 411 -G me thithje uji ≤ 0,5% dhe bërthamë betoni 3 cm të trashë me ndarës të derdhur. Sipërfaqe keramike graniti e strukturuar hollë me një pamje natyrale të dyshemesë prej druri. Pllakat duhet të jenë produkte nga prodhimi neutral ndaj klimës (certifikimi CCF) me një raport të verifikuar të qëndrueshmërisë. Duhet të respektohen udhëzimet për montim e prodhuesit dhe informacioni në DIN 18318, Format (A/B/H): 60/40/6 cm, Gjerësia e fugave: min.3 mm. Ngjyrat: bezhe me lara lara, Duhet të plotësoj RiBoN, Qeramike graniti 2 cm + bërthamë betoni 3 cm, Rezistent ndaj mykut, myshkut, likenit etj. Thithja e ujit ≤ 0,5%, për të bërë të lehtë pastërimin, Rezistent ndaj ngrirjes/shkrirjes, Rezistenca ndaj rrëshqitjes: R11 Mostra duhet t'i paraqiten klientit.									
m ²	2,428.97	64.07	18.00	75.60	155,618.76	28,011.38	183,630.13		
Muret perimetrike të objektit, t1=25cm, t2=20cm [C30/37, dmax=32mm, XC1] Llogaritet në m ³ (metër kub) të punuar. Per rampen	49.50	83.05	18.00	98.00	4,111.02	739.98	4,851.00		
Themeli Pllakë, t1=40cm, t2=65cm [C30/37, dmax=32mm, XC2]. Ne qmim të përfshihen edhe nivelimi, rrafshimi dhe përpunimi me (helikopter), si dhe dhenja e ramjeve per largimin e ujit sipas projektit.Llogaritet në m ³ (metër kub) të punuar . Betonimi i dysheneja se rapes.	29.48	67.80	18.00	80.00	1,998.64	359.76	2,358.40		
Themeli Pllakë, t1=40cm, t2=65cm [C30/37, dmax=32mm, XC2]. Ne qmim të përfshihen edhe nivelimi, rrafshimi dhe përpunimi me (helikopter), si dhe dhenja e ramjeve per largimin e ujit sipas projektit.Llogaritet në m ³ (metër kub) të punuar	58.50	67.80	18.00	80.00	3,966.10	713.90	4,680.00		
Shkallët e parafabrikuara ne forme harkore [C30/37, dmax=32mm, XC1] me gjatesi mesatare 11 m.Ballorja: nga 15 cm në 18 cm Shkelsja: nga 30 cm në 32 cm Ne qmim te llogaritet edhe pjesa e betonit nen shkalle. Llogaritet në m' (metër gjatesi) të punuar.	88.00	211.86	18.00	250.00	18,644.07	3,355.93	22,000.00		
Shkallët e parafabrikuara ne forme harkore [C30/37, dmax=32mm, XC1] me gjatesi mesatare 8.5 m.Ballorja: nga 15 cm në 18 cm Shkelsja: nga 30 cm në 32 cm Ne qmim te llogaritet edhe pjesa e betonit nen shkalle. Llogaritet në m' (metër gjatesi) të punuar.	68.00	237.29	18.00	280.00	16,135.59	2,904.41	19,040.00		
Armatura per elementet e betonit te armuar. [B-500B, d=8mm - 22mm] Armimi i mureve te rampes dhe dyshemes.	3.60	720.34	18.00	850.00	2,593.22	466.78	3,060.00		
							265,373.93		

Përshkrimi		Vlera me TVSH në €
PUNET E PILLAKAVE DHE BETONIT		265,373.93



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria për Prokurim Publik
14Nr.454/25
Dt. 17.06.2025

PROCESVERBAL

lidhur me procedurën E negociuar pa publikim të njoftimit për kontrat Rikostruimi i
bulevardit Adem Jashari

Kodi intern i procedurës VU644-25-4802-5-2-5

Takimi filloi në orën: 10:00.

Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë: nga AK-ja: Ilmi Azemi – Drejtor i DPP-së, Komisioni i negociimit dhe vlerësimit të ofertave 1.Arben Basholli,- Kryesues, 2. Luan Basholli – Anëtar dhe 3.Sabri Dallku – Anëtar të komisionit nga AK, ndërsa nga **Grup i Operatorëve Ekonomik ILEAA - GR SH.P.K.; LIMITPROJECT SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.; DELTA - CCD SH.P.K., Rr.Mehmet Gradica Hyrja 6/2, 10000, Prishtinë, Kosovë**, përfaqësuar me autorizim nga z. Besart Hetemaj me nrp.1173343180.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë ka zhvilluar procedurën **Rikostruimi i bulevardit**

Adem Jashari, Kodi intern i procedurës VU644-25-4802-5-2-5 dhe ka pranuar ofertën e rregullte në vlerë **265,373.93€**

Gjatë realizimit të negociatave, perfaqesuesi i operatori ekonomik i lartëpërmendur fillimisht ka ilustru shembujt dhe vlerat e propozuara duke justifiku se ne ofert kan ofertu me çmimet e kontratës bazë qe rezultoj të jenë çmime të vitit 2023, gjithashtu sqaron ne negociim se GOE ka ofertu me kto çmime per faktin se nuk kemi dashur të jemi jo korrekt me ofert dhe nuk kemi pasur qellim të ofertojm me çmime që do të komplikon zgjidhjen e çështjes, ne në shenjë respekti për institucionin Tuaj jemi të gatshëm të ofrojm një zbritje simbolike prej 0,5% nga vlere e ofertës.

Komisioni i AK-ja fillimisht ka kërkuar 1.3% zbritje dhe negociim mirëpo pasi perfaqesuesi i Oe ka arsyetu ofertën dhe çmimet komisioni i AK njëzëri është pajtuar me ofertën zyrtare të negociur dhe dakorduar prej 0,5% krejt kjo me qëllimin e ruajtjes se kualitetit dhe kuantitetit të punëve dhe pas shumë diskutimeve në mes të dy palëve negociuese, arrihet ujdia finale lidhur me ofertën financiare.

Lidhur me këtë AP, Komisioni i AK, në prezencën e – ZPP propozoi që të konstatohet marrëveshja me zbritjen 0,5% nga vlera e ofertës 265,373.93€ që do të thotë se vlera e Aneks Kontrates është **264,047.06€.**

Me nënshkrimin e pjesmarresve konstatohet marrëveshja e arritur.

Takimi përfundoi në orën: 11:02.

Procesverbalin e nënshkruan:

ZPP

Nga GOE

1.Arben Basholli,- Kryesues

Ilmi Azemi

Besart Hetemaj

2. Luan Basholli – Anëtar dhe

3.Sabri Dallku - Anëtar





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **140395**

Për **Komuna e Vushtrrisë**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **ILEAA-GR sh.p.k. & LIMIT PROJECT sh.p.k. & RINESA sh.p.k. & DELTA - CCD sh.p.k.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Rikostruimi i bulevardit Adem Jashari**

Nr. prokurimit: VU644-25-4802-5-2-5/C1046

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci. Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **26,537.40€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **26,537.40€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 20 ditë kalendarike prej **24.06.2025** deri më **14.07.2025**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 24.06.2025

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

E. S. H.



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: VU644-25-4802-5-2-5/C1046

Të dhënat e mëposhtme për mallrat që do të prokurohen do të plotësojnë, shtojnë, ose ndryshojnë dispozitat e Informatave për Tenderuesin. Kurdo që paraqitet ndonjë mospërputhje, këto dispozita do të mbizotërojnë mbi ato në Informata për Tenderuesit.

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve
Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit	
Fusha e tenderit	1.1	Autoriteti Kontraktues (AK) është: Emri i AK: KOMUNA E VUSHTRRIË Adresa e AK: HESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173 Qyteti: VUSHTRRI Kodi Postar: 42000 Adresa Elektronike: https://kk.rks-gov.net/vushtrri/ Personi Përgjegjës: Ilmi Azemi Personi Kontaktus: Azize Krasniqi E-mail: prokurimi.vushtrri@rks-gov.net Telefoni: 038/200-42403 038/200-42404
	1.2	Titulli i kontratës dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është: Rikostruimi i bulevardit Adem Jashari
	1.5	Tenderi duhet të dorëzohet në adresën e përmendur në 1.1
Qëllimi i Kontratës	2.1	Projekti ndertimin e bulevardit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit Adem Jashari Vushtrri ku gjatë implementimit të projektit dhe zhvillimit të punimeve është paraqitur nevoja për shtesë për disa pozicione . Bazuar në gjendjen faktike në terren për projektin ,pozicionet në vazhdim të paraqitura si punë shtesë të cilat janë të nevojshme dhe të domosdoshme të kryhen nga puna punë kryesore, pozicione pa të cilat nuk mund të vazhdojnë tutje me punë finale për të kryer këto punë . Kryerja e këtyre punëve ndërlidhen me punimet sipas kontratës bazë ,andaj në si AK mendojmë të shkojmë me të njëjtin OE i cili është duke ekzekutuar punimet e kontratës bazë. Vlera e parashikuar e kontratës bazë është 2,713,169.78 euro ,ndërsa punët shtesë e kanë vlerën prej 265,373.93euro ,vlerë kjo e cila shprehur në përqindje ka një pjesëmarrje prej 9.8% në vlerë të përgjithshme të kontratës bazë.
	2.3	Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):
Ndarja në Lote	2.5	Kjo kontratë nuk është e ndarë në pjesë (lote). Tenderi duhet të paraqet tërësinë e sasive të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Vlera e parashikuar	2.6	265,373.93 €
Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për punët e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe Listen e Përshkrimit të Çmimeve.
Variantet	4.1	Variantet nuk do të autorizohen.
Lloji i Kontratës, Kërkesat dhe Kushtet e Dërgesës, Kushtet e Kontratës	5.2	Vendi i kryerjes së punëve është: Ne bulevardit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit Adem Jashari referoju aneksit nr. 1
	5.3	Kushtet e dërgesës: DDP (detyrat e dërguara të paguara)
	5.4	Dërgesat do të kryhet VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj aneks-kontrate. Kjo aneks-kontratë për punë ka kohëzgjatje prej 10 ditë pune dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.
Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	6.4	Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 , Neni 65 Dëshmia 1. Lidhur me nenin 65, paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, të LPP-së me të cilën dëshmohet se tenderuesi i plotëson kërkesat e përshtatshmërisë për të konkuruar. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik , duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dëshmia 2. Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së, një ekstrakt nga regjistri gjyqësor (Gjykata Komerciale) apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik. Ekstrakti Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik të cilit synohet

		dhënia e kontratës (Original apo kopje e Noteruar) Dëshmia 3. Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, të LPP-së, një ekstrakt nga regjistri gjyqësor (Gjykata Themelore e vendit të themeluesit të OP. Ek.) apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65. Ekstrakti Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik. të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në Origjinal ose Kopje e Noteruar. Dëshmia 4. Në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8 i LPP-së, për kontributin e taksave një dëshmi e lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik . Dëshmia Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës (Kopje) Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla nga Operatori ekonomik i rekomanduar për shpërblim me kontratë, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1	Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
	7.2	Dëshmia 1: Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit); Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të jetë I regjistruar si deklarues I TVSh-së Certifikata e TVSH-së. Dëshmia 2. Çertifikata e TVSH-së.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe	8.1	N/A

financiare		
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	N/A
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. e. Secili anëtar i grupit të Operatoreve ekonomik duhet të regjistrohet në platformën elektronike.
Nënkontraktimet	12.1	a) një deklaratë ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe b) Të gjithë nënkontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.
Siguria e tenderit	13.1	N/A
Siguria e ekzekutimit	14.1	Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni, para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit.
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës .
Data e nënshkrimit të kontratës		24.06.2025 në ora 14:00
Dokumentet që përbejnë Tenderin	19.1 (h)	N/A
Valuta dhe Përshkrimi i Çmimit	20.2	Çmimi i ofruar nga Tenderuesi nuk <i>do të jetë</i> i ndryshueshëm. Ne Euro
Periudha vlefshmërisë së tenderit	22.1	Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 60 ditë.
Vulosja dhe Shënimi i Tenderëve	23.1	<i>OE duhet të dorëzojnë tenderët vetëm përmes platformës elektronike. Tenderët e dorëzuar në kopje fizike, do të refuzohen për nga aspekti administrativ.</i>
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	24.1	Afati i fundit për dorëzim është 12.06.2025 në 14:00:00 orë
Hapja e Tenderit	27.1	Hapja e tenderit do të bëhet me datën 12.06.2025 në 14:00:00 orë Vendi: Permes platformës së sistemit të e-prokurimit, Në Objektivin e Komunës, kati i II-të Drejtoria e prokurimit, zyra nr.45
Kriteret e Dhënies	31.1	Tenderi i përgjigjshëm me Çmimin më të ulët
Ankesat	32.3	Permes platformës së prokurimit elektronik -Komuna e Vushtrris